

VENDIM
Nr. 695 , datë 22.11.2017

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “MBROJTJA LUMORE E QYTETIT NGA PËRMBYTJA, EROZIONI I LUMIT OSUM DHE REHABILITIMI URBAN I KËSAJ ZONE”, URA VAJGURORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, dhe të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Mbrotja lumore e qytetit nga përmytja, erozioni i lumit Osum dhe rehabilitimi urban i kësaj zone”, Ura Vajguore.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Ura Vajguore.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë sipërfaqe “tokë truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 4 430 527 (katër milionë e katërqind e tridhjetë mijë e pesëqind e njëzet e shtatë) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 4 430 527 (katër milionë e katërqind e tridhjetë mijë e pesëqind e njëzet e shtatë) lekësh, do të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve” në Bankën e Shqipërisë.
5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.
7. Pronarët e listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, do të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Ura Vajguore.
8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Ura Vajguore, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të shtetit.
9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin që të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuar.

11. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat dhe Bashkia Ura

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PRONAVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I MBROJTJES LUMORE

[illegible]